

#PAKTI PËR UNIVERSITETIN

PREZANTOHET PROJEKTI I UNIVERSITETIT TË ARTEVE TË TIRANËS

Në kuadër të "Paktit për Universitetin", është prezantuar projekt-ideja e kampusit të ri të Universitetit të Arteve, një projekt nga arkitekti i mirënjohur italian Marco Casamonti. Ai është konceptuar në formën e një kampusi urban, i cili integron objektin historik të arkitektit Bosio me objektin e ri ku mendohet të pozicionohen Fakultetet e Arteve të Bukura, Muzikës dhe Artit Skenik.

Ministrja Shahini u shpreh se ky projekt do t'i rikthejë identitetin dhe vlerat një godine që mbart historinë e artit shqiptar. Sipas saj, projekti u jep zgjidhje nevojave emergjente të studentëve duke krijuar më shumë hapësira për ta dhe duke rikualifikuar gjithë zonën përreth.

Duke u ndalur tek "Pakti për Universitetin", ministrja nënvizoi se "Pakti për Universitetin" është vetëm fillimi dhe nuk ka asnjë kthim prapa, teksa përmendi edhe pika të tjera të rëndësishme të paktit tashmë të realizuara si biblioteka digjitale, krijimi i portalit për transparencën financiare; punësimi i mbi 400 studentëve ekselentë në administratën shtetërore; rreth 2 mijë praktika pune në kuadër të "Programit Kombëtar të Praktikave të Punës etj.

INTERPELANCË MBI KRITERIN E NOTËS MESATARE TË PRANIMIT NË UNIVERSITET

Ministrja Shahini është thirrur nga një grup deputetësh në një interpelancë në lidhje me përcaktimin e notës mesatare për pranimin në universitet.

Në fjalën e saj, Znj. Shahini theksoi se ky vendim i qeverisë shqiptare përmirëson në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e shërbimit arsimor të ofruar nga IAL-të, zhvillon arritjet akademike të studentëve që studiojnë në programe studimi të fushës së mësuesisë, si dhe mbështet nismat e ndërmarra në funksion të zhvillimit të arsimit profesional.

HAPET THIRRJA PËR SHKOLLËN VERORE 2019

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë organizojnë "Shkollën Verore 2019", me temë "Edukimi dhe Punësimi në Shekullin e 21-të". Ky aktivitet do të zhvillohet përgjatë datave 24 – 27 korrik 2019, në Jalë, Himarë, me pjesëmarrjen e 120 të rinjve nga të dy vendet organizatore.

"Shkolla Verore 2019" do të përfshijë një gamë të gjerë aktiviteteve, nisur nga trajnimet me tematika si: bashkëpunimi i të rinjve në Ballkanin Perëndimor; punësimi dhe sipërmarrja, bazuar në aftësitë digjitale; njohuritë praktike për një jetesë të shëndetshme; edukimi joformal i orientuar kah tregut të punës; komunikimi ndërkulturor/traditional vs. online; deri tek mbrojtja dhe kujdesi për mjedisin, lojërat sportive interaktive dhe aktivitetet me natyrë artistike e kulturore.

ZËVENDËSMINISTRJA HAXHIU, TAKIM ME STUDENTËT CICERONË TË EKSPOZITËS "AS MIK AS ARMIK"

Në përfundim të trajnimit për ciceronë, studentët janë pritur Zëvendësministrja për Rininë Znj. Lorena Haxhiu pranë ambjenteve të MASR.

Gjatë takimit, secili prej studentëve ciceronë ka ndarë përjetimin dhe ndikimin që kjo eksperiencë pati në formimin e tyre.

Ekspozita "As mik as Armik" e artistit Sokol Beqiri shërbeu si platformë për shkëmbim dijesh ndërmjet brezave dhe kishte si qëllim njohjen e moshave të reja me ngjarjet e ndodhura gjatë luftës në Kosovë duke përdorur artin si medium për edukim.

PARLAMENT

RINIA

RINIA